



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P 607/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.09.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së BOE “Biba X” shpk& “Pe-Vla-Ku” shpk nga procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-23534 -05 - 23–2019, me objekt “*Rikonstruksion i linjave te Puseve 281, 282, 283, Depos 500 m3, Ndertimi i pusit 7, Cerme*”, me fond limit 60,773,649 leke pa tvsh, zhvilluar në datën 15.07.2019 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kavaje.

Ankimues:

BOE “Biba X” shpk& “Pe-Vla-Ku” shpk
Fshati Kryeluzaj, Kavajë 50 m pranë karburant
“Eurodrin”

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Kavaje
Bulevardi “Josif Budo”

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:**I**

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor lidhur me skualifikimin e operatorit ekonomik “Boshnjaku B” shpk i cili nuk e ka pranuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik ku kërkon kualifikimin e ofertës së tij dhe skualifikimin e operatorit ekonomik “Boshnjaku B” shpk, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Nuk ka respektuar shkallët e ankimimit lidhur me skualifikimin e ofertës së tij.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 23.05.2019 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-23534 -05-23–2019, me objekt “Rikonstrukcion i

linjave te Puseve 281, 282, 283, Depos 500 m3, Ndertimi i pusit 7, Cerme", me fond limit 60 773 649 leke pa tvsh, zhvilluar në datën 15.07.2019 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kavaje.

II.2. Në datën 15.07.2019 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se në datën 15.07.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Mikael-Group shpk	pa ofertë	I skualifikuar
- Boshnjaku B & Bajrami N	49,654,253	I kualifikuar
- BOE Asfalt&Victoria Invest	50,379,230	I kualifikuar
- Biba X & Pe-Vla-Ku	51,657,602	I kualifikuar
- Shendelli & ED Konstruksion	51,942,159	I kualifikuar
- B-93&Lala&Arkonstudio	54,058,598	I kualifikuar
- Pesë Vëllezrit & Meteo	56,164,180	I kualifikuar
- Alko Impex General Construction&2T	57,729,371.25	I kualifikuar

II.4. Në datën 24.07.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Shendelli	51,942,159	I skualifikuar
- Lala	54,058,598	I skualifikuar
- Alko Impex General Construction	57,729,371.25	I kualifikuar
- Pesë Vëllezrit	56,164,180	I kualifikuar
- B-93	54,058,598	I skualifikuar
- Mikael-Group shpk	pa ofertë	I skualifikuar
- Biba X	51,657,602	I skualifikuar
- Boshnjaku B	49,654,253	I kualifikuar
- Al Asfalt	50,379,230	I skualifikuar

II.5. Në datën 22.07.2019 BOE "Biba X" & "Pe-Vla-Ko" shpk ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Së pari procedura e tenderimit është mbyllur për vlerësim më datë 12.07.2019 dhe më datë 15.07.2019 jemi njoftuar për vlerësimin e saj. Si mund që autoriteti juaj kontraktor të bëjë vlerësimin e ofertave për 7 operatorë ekonomikë për 6 orë punë nga momenti i mbylljes së procedurës së prokurimit.*

- Së dyti kualifikimi i OE Boshnjaku B është i padrejtë pasi ky OE është shpallur fitues në të gjitha objektet e prokurimit që AK juaj ka zhvilluar së fundmi. Mjetet që disponon i ka të angazhuara në kontrata të tjera.
- Operatori ekonomik Boshnjaku B shpk nuk plotëson kriterin sipas shtojcës nr.1 për modifikim dokumentacioni në tenderin me objekt sipas udhëzimeve të APP.....
- Kualifikimi i operatorit ekonomik Al Asfalt është i padrejtë pasi ky OE nuk plotëson kriteret nuk plotëson kriterin sipas shtojcës nr.1 për modifikim dokumentacioni në tenderin me objekt sipas udhëzimeve të APP. Makineritë e kërkuara shoqëria Al Asfalt nuk i zotëron sipas DST së tenderit.....

II.6. Në datën 24.07.2019 operatori ekonomik “Biba X” shpk & “Pe-Vla-Ku” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- *Oferta e B.O.E.: “Biba-X” Shpk & “Pe-Vla-Ku” Shpk nuk plotëson kriteret si më poshtë vijon: D.T. i “BIBA-X” Shpk, ing. Alida HOXHA, eshte e dy punesuar. Ajo eshte e punesuar prane shoqerise “BIBA-X” Shpk dhe prane shoqerise “ELECTRICAL POËER ENGINEERING” Shpk, nipt K81511012V, me objekt “Punime germimi ne toke. Ndertim dhe rikonstruksion I ndertesave civile dhe industriale, antena dhe rrjete te telekomunikacionit...”. D.T. i “BIBA-X” Shpk, ing. Hyqmet MUKA, eshte e tre punesuar. Ai eshte i punesuar prane shoqerise “BIBA-X” Shpk, prane shoqerise “KAZIU. B” Shpk, nipt K83310801B, dhe gjithashtu eshte i punesuar prane Bashkia Kavaje. Ky fakt perben dy shkelje, e para sepse drejtuesi teknik nuk mund te jete i punesuar ne asnje subjekt tjetër përveç ku eshte drejtue teknik dhe e dyta ofertuesi shoqeria “BIBA-X” Shpk eshte ne konflikt interesi. D.T. e “BIBA-X” Shpk, ing. Arbana KOLA, eshte e tre punesuar. Ajo eshte e punesuar prane shoqerise “BIBA-X” Shpk, prane shoqerise “KARL GEGA KONSTRUKSION” Shpk, nipt J66703076Ë, me objekt veprimtarie “Ndertime civile, industriale, etj., Studimin, projektimin, konsulencen, siper marrjen zbatuese dhe/ose investimin ne ndertimet civile, industriale, ushtarake etj., duke perfshire por pa u kufizuar ne ndertimin, rehabilitimin dhe mirembajtjet ne infrast...” dhe prane SHOQ. UJESEJLLES KANALIZIME E SHQIPERISE, nipt K82007454K. D.T. i “PE-VLA-KU” Shpk, ing. Klodian ZAIMI, eshte e tre punesuar. Ai eshte i punesuar prane shoqerise PE-VLA-KU” Shpk, prane shoqerise “HYDROËATER-ALBANIA” Shpk, nipt L12414005A, me objekt “Konsulence, projektim dhe supervizim, tregti, import eksport Studime, gjeologjike mjedisore, hidrologjike, rurale, topografike, organizime seminaresh, tranjim” dhe prane Inst. Gjeosh. Dhe Emergj, Ujit dhe Mjedis, nipt L12128451T. D.T. i “PE-VLA-KU” Shpk, ing. Mustafa Shema, eshte e dy punesuar. Ai eshte i punesuar prane shoqerise “PE-VLA-KU” Shpk dhe prane shoqerise “ANJANO 2017” Shpk, nipt L71410014G. D.T. e “PE-VLA-KU” Shpk, ing. Adelina Dukaj, eshte e tre punesuar. Ajo eshte e punesuar prane shoqerise “PE-VLA-KU” Shpk, prane shoqerise “G & G PALUCA”*

Shpk, nipt L08609501N, me objekt veprimtarie “Ndertim konstruksion dhe punime restaurimi, te objekteve civile, industriale, tregtare, turistike, shendetesore, kulturore, sportive, vepra kullimi dhe vaditje, infrastrukture, sherbime komunale, projektim i objekteve te treguara me siper...” dhe prane Bashkia Mirditë. D.T. e “PE-VLA-KU” Shpk, ing. Rudina Matoshi, eshte e dy punesuar. Ajo eshte e punesuar prane shoqerise “PE-VLA-KU” Shpk dhe prane Drejtoria Arsimore Qarkut, me NIPT K51713034R. D.T. i “PEVLA-KU” Shpk, ing. Përparim Domi, eshte i dy punesuar. Ai eshte i punesuar prane shoqerise “PE-VLA-KU” Shpk dhe prane shoqerise “Alb Telecom” Sh.A., me nipt J61824053N. D.T. e “PE-VLA-KU” Shpk, ing. Alma Velaj, nuk eshte me e punesuar prane shoqerise “PE-VLA-KU” Shpk nga muaji prill 2019. Deri ne muajin prill 2019 ka qene e dy punesuar prane shoqerise “PE-VLA-KU” Shpk dhe prane shoqerise “LINDNER ALBANIA” dege e shoqerise se huaj, me nr NIPT L32216010T. Nga muaji prill e ne vijim eshte e punesuar vetem prane shoqerise “LINDNER ALBANIA” dege e shoqerise se huaj, me objekt veprimtarie “Realizimi, transferimi dhe mbikqyrja e punimeve te ndertimit dhe punimeve te rifiniturave, projektim dhe konsulence ne fushen e inxhinierise civile ...”. D.T. i shoqerise “PE-VLA-KU” Shpk, ing. Sokol Qehajaj, eshte i dy punesuar. Ai eshte i punesuar prane shoqerise “PE-VLA-KU” Shpk dhe prane Bashkia Tirane. Ne kontraten e b. me numer 3891 Rep., nr 742 Kol., date 11.07.2019, palet kane rene dakorte qe punimet, II. Pusi I cpimit Nr. 7, Cerme, 1. Cpimi I pusit, zerin e punimeve nga 1 deri ne 13, ti realizoj shoqeria “Biba-X” Shpk. Ne licenen me nr NZ.4319/6, date 05.03.2019, rezulton se shoqeria “Biba-X” Shpk, nuk eshte e licencuar me kategorin e licences NS-20. Ne dokumentat e tenderit eshte kerkuar NS-20 / B. Shoqeria “Biba-X” Shpk, Nuk ka as inxhinier gjeolog te punesuar. Ne kontraten e b. me numer 3891 Rep., nr 742 Kol., date 11.07.2019, palet kane rene dakorte qe ne grup punimin II. Pusi I cpimit Nr. 7 , Cerme, 1. Cpimi I pusit, zerin e punimit nr 7, “Mbushje me zhavorr te situr 5-10 mm e kollones se pusit”, ta realizoj te gjithë volumin shoqeria “Pe-Vla-Ku” Shpk. Ndersa ne preventivin e punimeve, per ndarjen e punimeve qe do te realizoj secila shoqeri, eshte rene dakorte qe zerin e punimit nr 7, “Mbushje me zhavorr te situr 5-10 mm e kollones se pusit”, 3 m3 ta realizoj shoqeria “BibaX” Shpk dhe diferencen 4 m3 ta realizoj “Pe-Vla-Ku” Shpk. Ne secilin raste ndryshon edhe raporti I % se punimeve qe do te realizoj secila shoqeri. “Biba-X” Shpk, nuk ka plotesuar sakt shtojcen 1.1 DEKLARATË Për paraqitje Oferte të Pavarur. Ne Dokumentat e tenderit, eshte percaktuar se : 6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme): a). dhe b), ku ofertuesi duhet te percaktoj nje nga dy opsionet. Ky ofertues ka plotesuar opsionin e pare “Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër”, nderkohe qe ka mare pjese si bashkim operatoresh me shoqerin “Pe-Vla-Ku” Shpk. Ne piken dy te deklarates, percaktohet: “Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimet publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt”. “Biba-X”

Shpk, ne shtojcen nr 11, ka deklaruar se ushtron aktivitet per realizimin e kontrates nenshkruar ne daten 25.06.2019, per realizimin e objektit "Riparim infrastructure parku Rinia", me autoritet Kontraktor Ndermarrja e Sherbimeve Publike Korce, por nuk ka paraqitur document qe verteton se ka shlyer detyrimet vendore per vitin 2019 prane bashkia Korce. "Pe-Vla-Ku" Shpk, me deklarate, ka deklaruar se ne vitin 2018 dhe 2019 ka ushtuar aktivitet ne disa nipte sekondare, por nuk ka deklarur se ka shlyer detyrimet ne te gjitha vendet ku ushtron aktivitet, ne kundërshtim me dokumentat e tenderit. "Pe-Vla-Ku" Shpk, ne baze te ekstraktit historik, rezulton se kryen aktivitet ne adresat si me posht: Nga data 09/02/2018, e ne vazhdim, realizimin e objektit "Korce Pogradec POGRADEC Per realizimin e punimeve te Kontrates me nr. 3855/5, date 22.06.2017, me objekt: " Pjesa e mbetur e punimeve ne segmentin Lin- Pogradec, km 4 deri 21". Nga data 03/02/2016, e ne vazhdim, realizimin e objektit "Korce Pogradec POGRADEC Rehabilitimi i bregut te Liqenit te Ohrit dhe gjelberimi pergjate rruges se segmentit Lin-Pogradec". Nga data 02/03/2016, e ne vazhdim, realizimin e objektit "Korce Pogradec POGRADEC Sistemim asfaltim e masa inxhinierike ne km 21+050, ne rrugen Qafe Thane-Lin- Pogradec". Per kete arsye duhet te paraqiste vertetim nga bashkia Pogradec se ka shlyer detyrimet per vitin 2018 dhe 2019 prane kesaj bashkie. Ky ofertues ka paraqitur dokumentin me nr 1531 Prot., date 21.03.2018, ku verteton se nuk ka detyrime deri ne vitin 2018 por nuk ka paraqitur document qe verteton se nuk ka detyrime per vitin 2019. Nga data 17/05/2017 deri ne daten 12/04/2019, realizimin e objektit "Kukes; HAS; Krume; ; ZAHRISHT; Zaharisht, Rehabilitimi i rruges se fshatit Zaharisht, Has". Per kete arsye duhet te paraqiste vertetim nga bashkia Has se ka shlyer detyrimet per vitin 2018 dhe 2019 prane kesaj bashkie. Ky ofertues ka paraqitur dokumentin me Nr. S'ka Prot., date 20.03.2018, ku verteton se nuk ka detyrime deri ne vitin 2018 por nuk ka paraqitur document qe verteton se nuk ka detyrime per vitin 2019. "Pe-Vla-Ku" Shpk, nuk ka plotesuar sakt shtojcen 1.1 DEKLARATË Për paraqitje Oferte të Pavarur. Ne Dokumentat e tenderit, eshte percaktuar se : 6. Ofertuesi deklaroi se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme): a). dhe b), ku ofertuesi duhet te percaktoj nje nga dy opsionet. Ky ofertues ka plotesuar opsionin e pare "Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër", nderkohe qe ka mare pjese si bashkim operatoresh me shoqerine "Biba-X" Shpk. Ne piken dy te deklarates, percaktohet: "Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s'kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimet publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt". "Pe-Vla-Ku" Shpk, ne shtojcen 8, Deklaratë Mbi Përmbushjen E Kriteve Të Përgjithshme, nuk ka deklaruar te gjithë Personat në cilësinë e anëtarit të organit administrative, aksionerit ose ortakut. Sipas ekstraktit te shoqerise rezulton se ortake jane z. Vladimir Pjetergjokaj dhe Kujtim Arifaj dhe administrator eshte z. Vladimir Pjetergjokaj. Ne shtojce ky subjekt nuk ka plotesuar te dhenat per asnje nga keto dy persona. "Pe-Vla-Ku" Shpk, me deklarate, ka deklaruar se ne vitin 2018 ka ushtuar

aktivitet ne disa nipte sekondare dhe ne vitin 2019 ne bashkia Pogradec, por nuk ka deklarur se ka shlyer detyrimet ne te gjitha vendet ku ushtron aktivitet, ne kundërshtim me dokumentat e tenderit. "Pe-VlaKu" Shpk, ne shtojcen 11, deklarate mbi kontratat e lidhura dhe/ose ne proces, nuk ka deklaruar te gjitha procedurat per te cilin eshte shpallur fitues. Ne daten 05/07/2019, eshte shpallur fitues per objektin "Rikonstruksion Rruga Mukej" dhe per objektin " Rikonstruksion rruge "Bahcallek", me autoritet kontraktor, kontrata nuk eshte nenshkruar akoma, por kete procedure prokurimi nuk e ka deklaruar ne shtojcen 11. Sa më sipër, oferta e paraqitur nga B.O.E.: "Biba-X" Shpk & "Pe-Vla-Ku" Shpk, refuzohet për mospërmbushje të kriterëve të kualifikimit.

II.7. Në datën 30.07.2019 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.2393/3 i kthen përgjigje palës ankimese duke vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ku ndër të tjera sqarohet si vijon: Në bazë të ankesës KSHA ka konstatuar se oferta e paraqitur nga ofertuesi Biba X& Pe-Vla-Ku shpk ka mangësi të shumta në dokumentat e paraqitura për këtë procedurë prokurimi dhe nuk plotëson kërkesat thelbësore si taksat vendore, licencën, makineri etj. Drejtuesit teknikë janë të dy ose tre punësuar dhe disa drejtues teknik si Alma Velaj janë larguar dhe nuk janë më të punësuar pranë firmave antëtare të BOE. Për këtë arsye të cilat janë dërguar edhe nëpërmjet mesazhit në SPE të APP oferta juaj është skualifikuar. Për sa më sipër duke qënë se është bërë rivlerësim të ofertave dhe oferta juaj është skualifikuar ju duhet të kishit paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Në datën 29.07.2019 operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- Më datë 15.07.2019 BOE Biba X dhe Pe-Vla-Ku kualifikohen në këtë procedurë dhe në datë 25.07.2019 është po e njëjta KVO që e skualifikon këtë bashkim operatorësh. A mundet që e njëjta KVO të dalë me dy procesverbale për të njëjtën procedurë prokurimi . Të mbajë dy qëndrime dhe vlerësime të ndryshme për të njëjtin operator ekonomik.
- Së dyti në lidhje me refuzimin e argumentur nga KVO sqarojmë se BOE për përmbushjen e pikës 1 dhe 2 në DST BOE ka paraqitur licencat e kërkuara me kategoritë dhe me stafin teknik të kërkuara në pikën 2 të DST. Në lidhje me dypunësimin e drejtuesit teknik të gjithë kanë një kontratë pune me afat të përcaktuar të cilat për shoqërinë Pe-Vla-Ku janë të nënshkruara më së shumti në vitin 2017 dhe Licenca e zbatimit mban datën 05.03.2019. Pra i vetmi organ që kontrollon dhe miraton ligjshmërinë dhe përputhshmërinë e drejtuesit teknik është Komisioni i Licensimit. Të gjithë drejtuesit teknik figurojnë në listpagesa i paguhen detyrimet e sig shoqërore e shëndetësore. Për sa më sipër kjo arsye nuk qëndron.
- Së treti shoqëria Biba ka marrë pjesë në dy procedura prokurimi të organizuar nga i njëjti AK ku ka paraqitur Licencën NZ4319/6 datë 05.03.2019 dhe stafi teknik dhe në asnjë prej këtyre procedurave nuk është skualifikuar.

- Së katërti BOE shoqëria Biba X shpk dhe shoqëria Biba X shpk kanë paraqitur Formularin e Ofertës , Preventivin e Punimeve për të gjitha punimet që do të kryej, Grafikon e punimeve. Përkatësisht Biba X sipas preventivit 90 % të punimeve 46,491,592.96 dhe Pe-Vla-Ku 10 % të vlerës së punimeve të preventivit 5,166,009.07 dhe vlera totale e ofertës është 51,657,602.03 lekë. Kjo arsye nuk qëndron.
- Në lidhje me punimet Cpim pusi , shoqëria Biba X në shtojcën nr.10 të disponimit të makinierive ka paraqitur që ka në pronësi të saj një sond shpimi sic kërkohet dhe në DST për punimet e pusit.
- Shtojca 1/1 është e plotësuar nga të dy operatorët ekonomikë konform DST të tenderit dhe LPP pra kjo arsye nuk qëndron.
- Shoqëria Biba shpk ka paraqitur në shtojcë nr.11 ka deklaruar se ushtron aktivitetet për realizimin e kontratës në datën 25.06.2019 për realizimin e objektit “Riparim infrastrukture parku Rinia me AK Ndërmarrja e shërbimeve publike Korçë. Si mundet që shoqëria Biba X shpk të shlyej taksat kur ende nuk është pajisur me një Njoftim Vlerësim Detyimesh Vendore kur sapo e ka nënshkruar kontratën dhe ende nuk ka filluar ekzekutimin e saj. Kjo vlen edhe për shoqërinë Pe-Vla-Ku që në datën 05.07.2019 është shpallur fitues për objektin Rikonstruksion Rruga Mukej dhe për objektin Rikonstruksion rruge Bahcallëkme autoritet kontraktor Bashkia Shkodër kontrata nuk është nënshkruar akoma. Si mundet që një operator ekonomik për një kontratë që nuk është nënshkruar ende është në fazën e respektimit të afteve të ankimimit sipas LPP të paguajë detyrimet e taksave vendore apo të deklarojë sipas shtojcës nr.11 të DST. Shoqëria Pe-Vla Ku është brenda afateve për kryerjen e pagesave. Pra këto arsye nuk qëndrojnë.
- Së gjashti kualifikimi i operatorit ekonomik Boshnjaku B është i padrejtë pasi ky OE është shpallur fitues në të gjitha objektet e prokurimit që AK Bashkia Kavajë ka zhvilluar së fundmi gjatë periudhës së muajit Korrik 2019.
- Operatori ekonomik Boshnjaku B shpk nuk plotëson kriterin sipas shtojcës nr.1 për modifikim dokumentacioni në tenderin me objekt sipas udhëzimeve të APP. Kjo kompani nuk zotëron makineri pajisje . Kualifikimi i saj është i padrejtë pasi këto makineri janë të deklaruar dhe të angazhuara në kontrata të tjera të shpallur fitues nga i njëjti AK.
- Ju kërkohet anulimin e vendimit të AK Bashkia Kavajë për skualifikimin e ofertës të BOE Biba X &Pe-Vla- Ku dhe skualifikimin e operatorit Boshnjaku B.

II.9. Njëpërmjet shkresës nr.2393/3 prot., datë 30.07.2019 protokolluar me tonën me nr.1319/2 datë 05.08.2019 me objekt “Dërgohet informacion”, dhe nr.2393/6 prot datë 13.08.2019 Protokolluar me tonën me nr.1319/3 prot datë 15.08.2019 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e BOE ankimues “Biba X” & “Pe-Vla-Ku” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se në datën 15.07.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Mikael-Group shpk	pa ofertë	I skualifikuar
- Boshnjaku B & Bajrami N	49,654,253	I kualifikuar
- BOE Al Asphalt&Victoria Invest	50,379,230	I kualifikuar
- Biba X & Pe-Vla-Ku	51,657,602	I kualifikuar
- Shendelli & ED Konstruksion	51,942,159	I kualifikuar
- B-93&Lala&Arkonstudio	54,058,598	I kualifikuar
- Pesë Vëllezrit & Meteo	56,164,180	I kualifikuar
- Alko Impex General Construction&2T	57,729,371.25	I kualifikuar

III.1.2. Në datën 24.07.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Shendelli	51,942,159	I skualifikuar
- Lala	54,058,598	I skualifikuar
- Alko Impex General Construction	57,729,371.25	I kualifikuar
- Pesë Vëllezrit	56,164,180	I kualifikuar
- B-93	54,058,598	I skualifikuar
- Mikael-Group shpk	pa ofertë	I skualifikuar
- Biba X	51,657,602	I skualifikuar
- Boshnjaku B	49,654,253	I kualifikuar
- Al Asphalt	50,379,230	I skualifikuar

III.1.3. Në datën 22.07.2019 BOE “Biba X” & “Pe-Vla-Ko” shpk ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Së pari procedura e tenderimit është mbyllur për vlerësim më datë 12.07.2019 dhe më datë 15.07.2019 jemi njoftuar për vlerësimin e saj. Si mund që autoriteti juaj kontraktor të bëjë vlerësimin e ofertave për 7 operatorë ekonomikë për 6 orë punë nga momenti i mbylljes së procedurës së prokurimit.*
- *Së dyti kualifikimi i OE Boshnjaku B është i padrejtë pasi ky OE është shpallur fitues në të gjitha objektet e prokurimit që AK juaj ka zhvilluar së fundmi. Mjetet që disponon i ka të angazhuara në kontrata të tjera.*
- *Operatori ekonomik Boshnjaku B shpk nuk plotëson kriterin sipas shtojcës nr.1 për modifikim dokumentacioni në tenderin me objekt sipas udhëzimeve të APP.*
- *Kualifikimi i operatorit ekonomik Al Asphalt është i padrejtë pasi ky OE nuk plotëson kriteret nuk plotëson kriterin sipas shtojcës nr.1 për modifikim dokumentacioni në tenderin me objekt sipas udhëzimeve të APP. Makineritë e kërkuara shoqëria Al Asphalt nuk i zotëron sipas DST së tenderit.*

III.1.4. Në datën 24.07.2019 BOE “Biba X” & “Pe-Vla-Ku” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- *Oferta e B.O.E.: “Biba-X” Shpk & “Pe-Vla-Ku” Shpk nuk plotëson kriteret si më poshtë vijon: D.T. i “BIBA-X” Shpk, ing. Alida HOXHA, eshte e dy punesuar. Ajo eshte e punesuar prane shoqerise “BIBA-X” Shpk dhe prane shoqerise “ELECTRICAL POËER ENGINEERING” Shpk, nipt K81511012V, me objekt “Punime germimi ne toke. Ndertim dhe rikonstruksion I ndertesave civile dhe industriale, antena dhe rrjete te telekomunikacionit...”. D.T. i “BIBA-X” Shpk, ing. Hyqmet MUKA, eshte e tre punesuar. Ai eshte i punesuar prane shoqerise “BIBA-X” Shpk, prane shoqerise “KAZIU. B” Shpk, nipt K83310801B, dhe gjithashtu eshte i punesuar prane Bashkia Kavaje. Ky fakt perben dy shkelje, e para sepse drejtuesi teknik nuk mund te jete i punesuar ne asnje subjekt tjetër përveç ku eshte drejtue teknik dhe e dyta ofertuesi shoqeria “BIBA-X” Shpk eshte ne konflikt interesi. D.T. e “BIBA-X” Shpk, ing. Arbana KOLA, eshte e tre punesuar. Ajo eshte e punesuar prane shoqerise “BIBA-X” Shpk, prane shoqerise “KARL GEGA KONSTRUKSION” Shpk, nipt J66703076Ë, me objekt veprimtarie “Nderitime civile, industriale, etj., Studimin, projektimin, konsulencen, siper marrjen zbatuese dhe/ose investimin ne ndertimet civile, industriale, ushtarake etj., duke perfshire por pa u kufizuar ne ndertimin, rehabilitimin dhe mirembajtjet ne infrast...” dhe prane SHOQ. UJESEJLLES KANALIZIME E SHQIPERISE, nipt K82007454K. D.T. i “PE-VLA-KU” Shpk, ing. Klodian ZAIMI, eshte e tre punesuar. Ai eshte i punesuar prane shoqerise PE-*

VLA-KU” Shpk, prane shoqerise “HYDROËATER-ALBANIA” Shpk, nipt L12414005A, me objekt “Konsulence, projektim dhe supervizim, tregti, import eksport Studime, gjeologjike mjedisore, hidrologjike, rurale, topografike, organizime seminaresh, tranjim” dhe prane Inst. Gjeosh. Dhe Emergj, Ujit dhe Mjedis, nipt L12128451T. D.T. i “PE-VLA-KU” Shpk, ing. Mustafa Shema, eshte e dy punesuar. Ai eshte i punesuar prane shoqerise “PE-VLA-KU” Shpk dhe prane shoqerise “ANJANO 2017” Shpk, nipt L71410014G. D.T. e “PE-VLA-KU” Shpk, ing. Adelina Dukaj, eshte e tre punesuar. Ajo eshte e punesuar prane shoqerise “PE-VLA-KU” Shpk, prane shoqerise “G & G PALUCA” Shpk, nipt L08609501N, me objekt veprimtarie “Ndertim konstruksion dhe punime restaurimi, te objekteve civile, industriale, tregtare, turistike, shendetesore, kulturore, sportive, vepra kullimi dhe vaditje, infrastrukture, sherbime komunale, projektim i objekteve te treguara me siper...” dhe prane Bashkia Mirditë. D.T. e “PE-VLA-KU” Shpk, ing. Rudina Matoshi, eshte e dy punesuar. Ajo eshte e punesuar prane shoqerise “PE-VLA-KU” Shpk dhe prane Drejtoria Arsimore Qarkut, me NIPT K51713034R. D.T. i “PEVLA-KU” Shpk, ing. Përparim Domi, eshte i dy punesuar. Ai eshte i punesuar prane shoqerise “PE-VLA-KU” Shpk dhe prane shoqerise “Alb Telecom” Sh.A., me nipt J61824053N. D.T. e “PE-VLA-KU” Shpk, ing. Alma Velaj, nuk eshte me e punesuar prane shoqerise “PE-VLA-KU” Shpk nga muaji prill 2019. Deri ne muajin prill 2019 ka qene e dy punesuar prane shoqerise “PE-VLA-KU” Shpk dhe prane shoqerise “LINDNER ALBANIA” dege e shoqerise se huaj, me nr NIPT L32216010T. Nga muaji prill e ne vijim eshte e punesuar vetem prane shoqerise “LINDNER ALBANIA” dege e shoqerise se huaj, me objekt veprimtarie “Realizimi, transferimi dhe mbikqyrja e punimeve te ndertimit dhe punimeve te rifiniturave, projektim dhe konsulence ne fushen e inxhinierise civile ...”. D.T. i shoqerise “PE-VLA-KU” Shpk, ing. Sokol Qehajaj, eshte i dy punesuar. Ai eshte i punesuar prane shoqerise “PE-VLA-KU” Shpk dhe prane Bashkia Tirane. Ne kontraten e b. me numer 3891 Rep., nr 742 Kol., date 11.07.2019, palet kane rene dakorte qe punimet, II. Pusi I cpimit Nr. 7, Cerme, 1. Cpimi I pusit, zerin e punimeve nga 1 deri ne 13, ti realizoj shoqeria “Biba-X” Shpk. Ne licenen me nr NZ.4319/6, date 05.03.2019, rezulton se shoqeria “Biba-X” Shpk, nuk eshte e licencuar me kategorin e licences NS-20. Ne dokumentat e tenderit eshte kerkuar NS-20 / B. Shoqeria “Biba-X” Shpk, Nuk ka as inxhinier gjeolog te punesuar. Ne kontraten e b. me numer 3891 Rep., nr 742 Kol., date 11.07.2019, palet kane rene dakorte qe ne grup punimin II. Pusi I cpimit Nr. 7, Cerme, 1. Cpimi I pusit, zerin e punimit nr 7, “Mbushje me zhavorr te situr 5-10 mm e kollones se pusit”, ta realizoj te gjithë volumin shoqeria “Pe-Vla-Ku” Shpk. Ndersa ne preventivin e punimeve, per ndarjen e punimeve qe do te realizoj secila shoqeri, eshte rene dakorte qe zerin e punimit nr 7, “Mbushje me zhavorr te situr 5-10 mm e kollones se pusit”, 3 m3 ta realizoj shoqeria “BibaX” Shpk dhe diferencen 4 m3 ta realizoj “Pe-Vla-Ku” Shpk. Ne secilin raste ndryshon edhe raporti I % se punimeve qe do te realizoj secila shoqeri. “Biba-X” Shpk, nuk ka plotesuar sakt shtojcen 1.1 DEKLARATË Për paraqitje Oferte të Pavarur. Ne Dokumentat e tenderit,

eshte percaktuar se : 6. Ofertuesi deklaroi se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme): a). dhe b), ku ofertuesi duhet te percaktoj nje nga dy opsionet. Ky ofertues ka plotesuar opsionin e pare “Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër”, nderkohe qe ka mare pjese si bashkim operatoresh me shoqerin “Pe-Vla-Ku” Shpk. Ne piken dy te deklarates, percaktohet: “Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimet publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt”. “Biba-X” Shpk, ne shtojcen nr 11, ka deklaruar se ushtron aktivitet per realizimin e kontrates nenshkruar ne daten 25.06.2019, per realizimin e objektit “Riparim infrastrukture parku Rinia”, me autoritet Kontraktor Ndermarrja e Sherbimeve Publike Korce, por nuk ka paraqitur document qe verteton se ka shlyer detyrimet vendore per vitin 2019 prane bashkia Korce. “Pe-Vla-Ku” Shpk, me deklarate, ka deklaruar se ne vitin 2018 dhe 2019 ka ushtuar aktivitet ne disa nipte sekondare, por nuk ka deklarur se ka shlyer detyrimet ne te gjitha vendet ku ushtron aktivitet, ne kundërshtim me dokumentat e tenderit. “Pe-Vla-Ku” Shpk, ne baze te ekstraktit historik, rezulton se kryen aktivitet ne adresat si me posht: Nga data 09/02/2018, e ne vazhdim, realizimin e objektit “Korce Pogradec POGRADEC Per realizimin e punimeve te Kontrates me nr. 3855/5, date 22.06.2017, me objekt: " Pjesa e mbetur e punimeve ne segmentin Lin- Pogradec, km 4 deri 21". Nga data 03/02/2016, e ne vazhdim, realizimin e objektit “Korce Pogradec POGRADEC Rehabilitimi i bregut te Liqenit te Ohrit dhe gjelberimi pergjate rruges se segmentit Lin-Pogradec”. Nga data 02/03/2016, e ne vazhdim, realizimin e objektit “Korce Pogradec POGRADEC Sistemim asfaltim e masa inxhinierike ne km 21+050, ne rrugen Qafe Thane-Lin- Pogradec”. Per kete arsye duhet te paraqiste vertetim nga bashkia Pogradec se ka shlyer detyrimet per vitin 2018 dhe 2019 prane kesaj bashkie. Ky ofertues ka paraqitur dokumentin me nr 1531 Prot., date 21.03.2018, ku verteton se nuk ka detyrime deri ne vitin 2018 por nuk ka paraqitur document qe verteton se nuk ka detyrime per vitin 2019. Nga data 17/05/2017 deri ne daten 12/04/2019, realizimin e objektit “Kukes; HAS; Krume; ; ZHRISHT; Zaharisht, Rehabilitimi i rruges se fshatit Zaharisht, Has”. Per kete arsye duhet te paraqiste vertetim nga bashkia Has se ka shlyer detyrimet per vitin 2018 dhe 2019 prane kesaj bashkie. Ky ofertues ka paraqitur dokumentin me Nr. S’ka Prot., date 20.03.2018, ku verteton se nuk ka detyrime deri ne vitin 2018 por nuk ka paraqitur document qe verteton se nuk ka detyrime per vitin 2019. “Pe-Vla-Ku” Shpk, nuk ka plotesuar sakt shtojcen 1.1 DEKLARATË Për paraqitje Oferte të Pavarur. Ne Dokumentat e tenderit, eshte percaktuar se : 6. Ofertuesi deklaroi se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme): a). dhe b), ku ofertuesi duhet te percaktoj nje nga dy opsionet. Ky ofertues ka plotesuar opsionin e pare “Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër”, nderkohe qe ka mare pjese si bashkim operatoresh me shoqerin “Biba-X” Shpk. Ne piken dy te deklarates, percaktohet: “Unë kuptoj që oferta e

paraqitur do të s'kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimet publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt". "Pe-Vla-Ku" Shpk, ne shtojcen 8, Deklaratë Mbi Përmbushjen E Kritereve Të Përgjithshme, nuk ka deklaruar te gjithë Personat në cilësinë e anëtarit të organit administrative, aksionerit ose ortakut. Sipas ekstraktit te shoqerise rezulton se ortake jane z. Vladimir Pjetergjokaj dhe Kujtim Arifaj dhe administrator eshte z. Vladimir Pjetergjokaj. Ne shtojce ky subjekt nuk ka plotesuar te dhenat per asnje nga keto dy persona. "Pe-Vla-Ku" Shpk, me deklarate, ka deklaruar se ne vitin 2018 ka ushtuar aktivitetet ne disa nipte sekondare dhe ne vitin 2019 ne bashkia Pogradec, por nuk ka deklaruar se ka shlyer detyrimet ne te gjitha vendet ku ushtron aktivitetet, ne kundërshtim me dokumentat e tenderit. "Pe-VlaKu" Shpk, ne shtojcen 11, deklarate mbi kontratat e lidhura dhe/ose ne proces, nuk ka deklaruar te gjitha procedurat per te cilin eshte shpallur fitues. Ne daten 05/07/2019, eshte shpallur fitues per objektin "Rikonstruksion Rruga Mukej" dhe per objektin " Rikonstruksion rruge "Bahcallek", me autoritet kontraktor, kontrata nuk eshte nenshkruar akoma, por kete procedure prokurimi nuk e ka deklaruar ne shtojcen 11. Sa më sipër, oferta e paraqitur nga B.O.E.: "Biba-X" Shpk & "Pe-Vla-Ku" Shpk, refuzohet për mospërmbushje të kritereve të kualifikimit.

III.1.5. Në datën 30.07.2019 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.2393/3 i kthen përgjigje palës ankimuese duke vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ku ndër të tjera sqarohet si vijon: *Në bazë të ankesës KSHA ka konstatuar se oferta e paraqitur nga ofertuesi Biba X& Pe-Vla-Ku shpk ka mangësi të shumta në dokumentat e paraqitura për këtë procedurë prokurimi dhe nuk plotëson kërkesat thelbësore si taksat vendore, licencën, makineri etj. Drejtuesit teknikë janë të dy ose tre punësuar dhe disa drejtues teknik si Alma Velaj janë larguar dhe nuk janë më të punësuar pranë firmave antëtare të BOE. Për këtë arsye të cilat janë dërguar edhe nëpërmjet mesazhit në SPE të APP oferta juaj është skualifikuar.*

Për sa më sipër duke qënë se është bërë rivlerësim të ofertave dhe oferta juaj është skualifikuar ju duhet të kishit paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor.

III.1.6. Në datën 29.07.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Më datë 15.07.2019 BOE Biba X dhe Pe-Vla-Ku kualifikohen në këtë procedurë dhe në datë 25.07.2019 është po e njëjta KVO që e skualifikon këtë bashkim operatorësh. A mundet që e njëjta KVO të dalë me dy procesverbale për të njëjtën procedurë prokurimi . Të mbajë dy qëndrime dhe vlerësime të ndryshme për të njëjtin operator ekonomik.*
- *Së dyti në lidhje me refuzimin e argumentur nga KVO sqarojmë se BOE për përmbushjen e pikës 1 dhe 2 në DST BOE ka paraqitur licencat e kërkuara me kategoritë dhe me stafin teknik të kërkuara në pikën 2 të DST. Në lidhje me dypunësimin e drejtuesit teknik të gjithë kanë një kontratë pune me afat të përcaktuar të cilat për shoqërinë Pe-Vla-Ku janë*

të nënshkruara më së shumti në vitin 2017 dhe Licenca e zbatimit mban datën 05.03.2019. Pra i vetmi organ që kontrollon dhe miraton ligjshmërinë dhe përputhshmërinë e drejtuesit teknik është Komisioni i Licensimit. Të gjithë drejtuesit teknik figurojnë në listpagesa i paguhen detyrimet e sig shoqërore e shëndetësore. Për sa më sipër kjo arsye nuk qëndron.

- Së treti shoqëria Biba ka marrë pjesë në dy procedura prokurimi të organizuar nga i njëjti AK ku ka paraqitur Licencën NZ4319/6 datë 05.03.2019 dhe stafi teknik dhe në asnjë prej këtyre procedurave nuk është skualifikuar.
- Së katërti BOE shoqëria Biba X shpk dhe shoqëria Biba X shpk kanë paraqitur Formularin e Ofertës , Preventivin e Punimeve për të gjitha punimet që do të kryej, Grafikon e punimeve. Përkatësisht Biba X sipas preventivit 90 % të punimeve 46,491,592.96 dhe Pe-Vla-Ku 10 % të vlerës së punimeve të preventivit 5,166,009.07 dhe vlera totale e ofertës është 51,657,602.03 lekë. Kjo arsye nuk qëndron.
- Në lidhje me punimet Cpim pusi , shoqëria Biba X në shtojcën nr.10 të disponimit të makinierive ka paraqitur që ka në pronësi të saj një sond shpimi sic kërkohet dhe në DST për punimet e pusit.
- Shtojca 1/1 është e plotësuar nga të dy operatorët ekonomikë konform DST të tenderit dhe LPP pra kjo arsye nuk qëndron.
- Shoqëria Biba shpk ka paraqitur në shtojcë nr.11 ka deklaruar se ushtron aktivitetet për realizimin e kontratës në datën 25.06.2019 për realizimin e objektit “Riparim infrastrukture parku Rinia me AK Ndërmarrja e shërbimeve publike Korçë. Si mundet që shoqëria Biba X shpk të shlyej taksat kur ende nuk është pajisur me një Njoftim Vlerësim Detyimesh Vendore kur sapo e ka nënshkruar kontratën dhe ende nuk ka filluar ekzekutimin e saj. Kjo vlen edhe për shoqërinë Pe-Vla-Ku që në datën 05.07.2019 është shpallur fitues për objektin Rikonstruksion Rruga Mukej dhe për objektin Rikonstruksion rruge Bahcallëkme autoritet kontraktor Bashkia Shkodër kontrata nuk është nënshkruar akoma. Si mundet që një operator ekonomik për një kontratë që nuk është nënshkruar ende është në fazën e respektimit të afteve të ankimimit sipas LPP të paguajë detyrimet e taksave vendore apo të deklarojë sipas shtojcës nr.11 të DST. Shoqëria Pe-Vla Ku është brenda afateve për kryerjen e pagesave. Pra këto arsye nuk qëndrojnë.
- Së gjashti kualifikimi i operatorit ekonomik Boshnjaku B është i padrejtë pasi ky OE është shpallur fitues në të gjitha objektet e prokurimit që AK Bashkia Kavajë ka zhvilluar së fundmi gjatë periudhës së muajit Korrik 2019.
- Operatori ekonomik Boshnjaku B shpk nuk plotëson kriterin sipas shtojcës nr.1 për modifikim dokumentacioni në tenderin me objekt sipas udhëzimeve të APP. Kjo kompani nuk zotëron makineri pajisje . Kualifikimi i saj është i padrejtë pasi këto makinieri janë të deklaruar dhe të angazhuara në kontrata të tjera të shpallur fitues nga i njëjti AK.
- Ju kërkohet anulimin e vendimit të AK Bashkia Kavajë për skualifikimin e ofertës të BOE Biba X &Pe-Vla- Ku dhe skualifikimin e operatorit Boshnjaku B.

III.1.7. Sa më sipër, konstatohet se për BOE ankimues Biba X &Pe-Vla- Ku shpk në rivlerësimin e procedurës të datës 24.07.2019 ka ndryshuar statusi duke u skualifikuar nga procedura e prokurimit objekt ankimi. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor sqarohet se rivlerësimi i proedurës është kryer në bazë të ankesave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në përputhje me LPP.

III.1.8. Rezulton se në ankesën e datës 22.07.2019 drejtuar autoritetit kontraktor BOE ankimues Biba X& Pe-Vla-Ku shpk ka ngritur pretendime lidhur me vlerësimin e procedurës të datës 15.07.2019 duke kërkuar skualifikimin e operatorëve ekonomikë “Boshnjaku B” shpk dhe “Al Asphalt” shpk. Ndërkohë konstatohet se në datën 24.07.2019 BOE ankimues është njoftuar lidhur me arsyet e veta të skualifikimit nga procedura e prokurimit objekt ankimi. Në ankesën drejtuar KPP BOE ankimues kundërshton arsyet e veta të skualifikimit dhe njëherazi kërkon skualifikimin e operatorit ekonomik “Boshnjaku B” shpk.

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr. 9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të cilin është parashikuar:

1. Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.

1.1 Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.

1.2 2. Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.

1.3 5. Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.

1.4 6. Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar

nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor”.

III.1.10. Në nenin 20 të VKM nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” parashikohet si vijon:

1. Ankesa drejtuar Komisionit paraqitet në gjuhën shqipe në përputhje me formularin standard të ankesës sipas modelit të aneksit nr. 2, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje. Komisioni publikon në faqen zyrtare formularin standard të ankesës.

2. Ankesa duhet të përmbajë domosdoshmërisht elementet e mëposhtme:

a) Të dhënat identifikuese të ankimuesit;

b) Referimin për procedurën konkrete mbi të cilën paraqitet ankimi

c) Bazën ligjore;

d) Një përshkrim të shkurtër të shkeljes së pretenduar;

e) Shkallët e ankimit shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e autoritetit kontraktor, nëse ka;

f) Dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën;

g) Pretendimin e ankuesit për vendimin përfundimtar.

3. Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me:

a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;

b) kërkesën për përjashtimin e ndonjë anëtari të Komisionit për shkak të konfliktit të interesit, nëse ankimuesi ka dijeni paraprakisht për shkakun;

c) kërkesën për ekspertizë të posaçme, kur kjo çmohet e nevojshme për zgjidhjen e çështjes.

III.1.11. Sa më sipër, KPP gjykon se pretendimet e operatorit ekonomik ankimues të ngritura pranë KPP-së lidhur me skualifikimin e ofertës së tij nuk kanë respektuar shkallët e ankimit të parashikuar nga neni 63 i LPP si më sipërcituar. KPP gjykon se BOE ankimues në momentin e marrjes dijeni lidhur me arsyet e veta të skualifikimit duhet të kishte paraqitur ankesë së pari pranë autoritetit kontraktor në respekt të shkallëve të ankimit. Ankimi i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke mos respektuar

shkallët e ankimimit sikurse përcaktohet në ligjin e sipërcituar, sjell si pasojë që ai të mos ketë përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit në autoritetin kontraktor, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës” dhe përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues, në respektim të shkallëve të ankimimit, duhet të kishte ngritur këto pretendime pranë autoritetit kontraktor, ashtu sikurse është përcaktuar specifikisht në ligjin e prokurimit publik. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se nuk mund të shprehet mbi pretendime të cilat nuk janë bërë paraprakisht objekt ankese pranë autoritetit kontraktor. Objekti i ankesës së paraqitur pranë autoritetit kontraktor në respekt të shkallëve të ankimimit nuk mund të shtohet në momentin e paraqitjes në KPP.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, për shkak të ligjit (ipso lege), pretendimet e BOE ankimues lidhur me skualifikimin e tij të cilat nuk janë ngritur fillimisht pranë autoritetit kontraktor, nuk mund të merren në shqyrtim nga KPP.

III.2. Lidhur me pretenidmet e BOE ankimues mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Boshnjaku B” shpk, KPP sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”*

Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk ka ndonjë interes të ligjshëm për të mbrojtur. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk arrin të realizojë interesin e tij të ligjshëm.

Duke analizuar rastin në shqyrtim, në kontekst të këtij precedenti, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, pretendimi i BOE ankimues nuk legjitimohet pasi, interesi i tij i ligjshëm, nuk ka sesi të dëmtohet nga dështimi i operatorit ekonomik “Boshnjaku B” sh.p.k sa kohë që vetë bashkimi i operatorëve ekonomikë “Biba X” shpk& “Pe-Vla-Ku” shpk ngelen të skualifikuar në procedurën e prokurimit objekt ankimi pasi sikundër arsyetuar edhe më sipër nuk kanë respektuar shkallët e ankimimit lidhur me arsyet e tyre të skualifikimit.

Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Kjo praktikë e KPP tashmë është konsoliduar edhe nga vendimmarrja gjyqësore, duke u lënë në fuqi përmes vendimesh përfundimtare.

Rrjedhimisht, pretendimet e BOE Biba X” shpk & “Pe-Vla-Ku” shpk nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE ankimues “Biba X” shpk & “Pe-Vla-Ku” shpk për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF- 23534 -05 -23–2019, me objekt “*Rikonstruktion i linjave te Puseve 281, 282, 283, Depos 500 m3, Ndertimi i pusit 7, Cerme*”, me fond limit 60,773,649 leke pa tvsh, zhvilluar në datën 15.07.2019 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kavaje.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1319 Protokoli, Datë 29.07.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha